



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI I SHQIPËRISË**  
**ALEANCA E GRAVE DEPUTETE**

**Sesion informimi “Barazia Gjinore dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) - Matja e efikasiteti i arritjes së integrimit të barazisë gjinore dhe OZHQ (SDGs).”**

Më datë 12.10.2020, Aleanca e Grave Deputete dhe Nënkomisioni Parlamentar për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas morën pjesë në një sesion informimi/diskutimi online me temë: **“Barazia Gjinore dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) - Matja e efikasiteti i arritjes së integrimit të barazisë gjinore dhe OZHQ (SDGs).”**

Gjatë këtij sesioni përfaqësuesit e Prezencës së OSBE-së dhe të Zyrës së Kombeve të Bashkuara prezantuan rëndësinë e perspektivës gjinore dhe rolin e saj si një domosdoshmëri për arritjen e Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm si dhe rolin e Parlamentit në këtë drejtim.

Gjatë diskutimit, deputetet prezantuan hapat e ndërmarra dhe punën e kryer nga Kuvendi i Shqipërisë mbi integrimin gjinor dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Gjithashtu, deputetet paraqitën propozime konkrete lidhur me hapat në të ardhmen në sesione të tilla informuese.

Ky sesion informues u organizua nga Prezenca e OSBE-së Tiranë dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara në Tiranë.